

VENDIM
Nr. 23/2022

**PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË LARTË
TË PROKURORISË NGA TRUPA E PEDAGOGËVE TË FAKULTETEVE
TË DREJTËSISË DHE TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS, SIPAS LIGJIT
NR. 115/2016, “PËR ORGANET E QEVERISJES SË SISTEMIT TË DREJTËSISË”**

Në mbështetje të nenit 147, pika 8, të Kushtetutës dhe nenit 35, pika 16, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Të konsiderojë të zgjedhur kandidatin e listës së tretë për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë që ka rezultuar nga hedhja e shortit në Nënkomisionin për Përzgjedhjen e Kandidatëve për Anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga Trupa e Pedagogëve të Fakulteteve të Drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës për shkak të mosarritjes së shumicës prej dy të tretave të votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit si më poshtë:

1. Mirela Bogdani

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar më datë 24.2.2022.